

AFATE

- **Sipas ligjit 78/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e QBZ-së”**

Neni 10

Afati i botimit

1. Afati i botimit të akteve të botueshme është jo më vonë se 10 ditë nga data e ardhjes së aktit për botim.
2. Afati i botimit të akteve të botueshme për Gjykatën Kushtetuese parashikohet në ligjin organik të këtij institucioni.
3. Në rast të masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevoje dhe urgjence, institucioni i interesuar bën kërkesë të arsyetuar për botimin sa më parë të një akti në numrin më të parë të Fletores Zyrtare të radhës.
4. Mosrespektimi i afateve të botimit, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative.

- Sipas vkm 214 / 2015 “ **Për përcaktimin e afateve dhe masave që duhet të merren në lidhje me ankesat për gabimet dhe defektet e botimit dhe publikimit** ”

1. Qendra e Botimeve Zyrtare pranon ankesat lidhur me gabimet dhe defektet që kanë të bëjnë me botimin dhe publikimin e akteve të botueshme në Fletoren Zyrtare, si dhe të njoftimeve në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në formë të shtypur ose në formë elektronike.
.....
4. Afatet e trajtimit të këtyre ankesave janë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së ankesës. Qendra e Botimeve Zyrtare, brenda këtij afati, i dërgon përgjigje institucionit apo personit që ka bërë ankesën, duke dhënë informacion edhe për masat e marra.

Sipas ligjit 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”

Neni 15

Afati për marrjen e informacionit

1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

Neni 8

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

1. Autoriteti publik krijon, mban dhe bën public një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.